

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPERNDARJES SH.A  
DREJTORIA RAJONALE ELBASAN**

Nr. Prot \_\_\_\_\_

Elbasan, më 08.09.2026

**PROCESVERBAL Nr. 1 - Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje kabell TM dhe kabell TU”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- Materiale elektrike 31681410-0

**VLERA E FONDIT LIMIT: 250.000.000** (dyqind e pesedhjetë milion) lekepa TVSH ose e konvertuar në valute - 2.713.851,5 (dy milion e shtatëqind e trembedhjetë mijë e tetëqind e e pesedhjetë e një presje pese) Euro pa TVSH sipas nivelit të kembimit zyrtar dt. 04.09.2026 të Bankes së Shqipërisë (1 EUR = 92.12) lek)

**Ndarje në Lote - Nuk ka**

Arsyeja pse është marrë vendim në lidhje me mosparashikimin e ndarjes në lote është bërë duke patur parasysh faktin se Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Elbasan po prokuron për llogari të OSSH sh.a Qender (Tiranë), e cila do të bëjë plan shpërndarje sipas kërkesave të drejtorive rajonale, kërkesa këto të cilat duhet të miratohen me pare nga OSSH sh.a Qender. Gjithashtu mos ndarja në lote është me pak e kushtueshme për AK, pasi kjo do të përfshijë vetëm një kontratë. Menaxhimi dhe ofrimi i furnizimeve mund të jenë më të lehta dhe më pak të kushtueshme për sa i takon kohës, burimeve njerëzore dhe logjistike.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros në të paktën njërin prej tre viteve, të jetë jo më e vogël se 100 % e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

OE ofertues duhet të ketë kapacitetin e duhur ekonomik dhe për këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros në të paktën njërin prej tre viteve, të jetë jo më e vogël se 100 % të fondit total limit që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të vërtetuar të bilanceve, të audituara nga ekspertet kontabël të licencuar, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse të Administratës Tatimore, të tre viteve të fundit (2023, 2024, 2025), ku të paktën në dy bilance të njepasnjeshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Akt Ekspertizen te Ekspertit Kontabel te Autorizuar, duhet te paraqitet nga Operatori Ekonomik vetem ne rastet kur jane ne kushtet e percaktuara nga neni 41, germa 'c' e ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" ( i ndryshuar).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2026 (per NIPT-in kryesor dhe per NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Ky kriter te permbushet nepermjet paraqitjes se formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas Shtojces Nr.9 te DST.

**Argumentimi:** Gjithashtu ne lidhje me kerkesen per pagesen e taksave vendore referojme se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit per te paraqitur dokumentacionin e shlyerjes se taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë te vertetojne se ushtrojne aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e kërkuar që është brenda vlerës së përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

---

### 2.3.2 Dokumentacioni

#### **Per mallrat objekt prokurimi - “Blerje kabell ABC dhe kabell TU”**

#### **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit / distributorit për mallin e kërkuar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

**Argumentimi:** Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë

teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, Operatori Ekonomik duhet te paraqese: Katalogun/et ose fragmente te katalogut /eve te prodhuesit/ve per mallrat objekt prokurimi ku te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. *Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

**Argumentim:** Kriteri i kerkuar ne lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur ne perputhje me piken 6/b, te Nenit 40 te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera per mallrat objekt prokurimi te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e mallrave te prodhuara (lista e mesiperme e mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kriteret e kualifikimit vendosen qe ti sherbejne AK-se, per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te OE-ve, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme si aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur si dhe cdo element tjeter ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne permbushje te kriterit te mesiperm, Operatoret Ekonomike, duhet te paraqesin deshmi te testimeve zyrtare te kryera, leshuar nga institucione te autorizuar, ose nga prodhuesi, per mallrat e cituar me siper, per te krijuar bindjen se malli i ofruar eshte brenda parametreve te kerkuara. Eshte ne te drejten e AK te kerkoje deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike te vendosura, perpara se AK te beje perzgjedhjen e OE-se fituese. Kjo kerkese eshte ne perputhje me piken 6/c, te nenit 40 te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

4. Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikate te vlefshme qe verteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit te cilesise se tij eshte ne perputhje me ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara. Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomike, secili anetar duhet te paraqese certifikatat ISO te sipercituara.

**Argumentimi:** Ne lidhje me kërkesën qe OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikaten e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001 eshte e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyren dhe vleren e kontrates, me qellim per te vertetuar dhe te garantoje realizimin ne kohe, me sukses dhe me cilesi sipas standarteve nderkombetare te objektit te kontrates. Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

5. Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklaronte se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesit / ve , furnizuesit/ve, eshte sipas standartit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara.

**Argumentimi:** Ky kriter eshte kerkuar pasi vetëm prodhuesi mund të vërtetojë se produktet e prodhuara kanë në fakt, karakteristikat e deklaruar. Certifikata e sigurimit të cilësisë ka për qëllim të plotësojë deklaratën fillestare apo certifikatën e përshtatshmërisë. Si provë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e produktit, prodhuesi pajiset me certifikatën për cilësinë e sistemit të kontrollit i cili monitoron fabrikimin e produkteve të caktuara. Këto certifikata bazohen në standardet ndërkombëtare ISO 9001: 2000.

6. Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate akreditimi ISO 17025 te laboratorit te prodhuesit (ose distributori i autorizuar) per testimin e kabllave me izolacion XLPE ose ekuivalenten e saj sipas Drejtorise se Pergjithshme te Standartizimit Shqiptar.

**Argumentimi:** ISO / IEC 17025 eshte standarti kryesor ISO i perdorur nga labororet testues dhe kalibruar , standarti per te cilin shume labororte duhet te akreditohen ne menyre qe te konsiderohen teknikisht kompetente. ISO/IEC 17025 specifikon kerkesat e pergjithshme per te kryer teste dhe/ose kalibrime, duke perfshire marrjen e mostrave. Standarti mbulon testimin dhe kalibrimin e kryer duke perdorur metoda standarte, metoda jo-standarte dhe metodat laboratorike te zhvilluara.

Standarti eshte i aplikueshem, per te gjitha kompanite qe kryejne teste dhe-ose kalibrime. Ketu perfshihen laborore te klases se pare, dyte dhe te trete, dhe laborore ku testimi dhe/ose kalibrimi eshte pjese e inspektimit dhe certifikimit te produktit.

ISO / IEC 17025 eshte eshte i zbatueshem per te gjitha labororet , pavaresisht nga numri i personelit ose shtrirjes se fushes se testimi dhe/ose kalibrimit.

Labororet perdorin standartin ISO / IEC 17025 per te zbatuar nje sistem te cilesise qe synon permiresimin e aftesise se tyre per te prodhuar vazhdimisht rezultate te vlefshme. Ky standart eshte gjithashtu baze per akreditim nga nje autoritet akreditues. Klientet e labororeve, autoritetet rregullatore dhe organet e akreditimit mund ta perdorin standartin ne konfirmimin ose njohjen e kopetences se labororeve.

Si nje laborator i akredituar me ISO 17025:2017, ISO / IEC 17025 perfshin njohjen e kompetences teknike te labororeve.

- Kërkesa teknike të permiresuara ku përfshin shtimin e trajnimeve të personelit dhe të dhëna të detajuara, zhvillimin e metodës dhe procedurave të validimit, matjen e metodës të pasigurisë dhe kalibrimit të pajisjeve të caktuara dhe program mirenjajtjeje
  - Një perkufizim më të fortë të procesit të përgatitjes së mostres do të dokumentohet për të ruajtur qëndrueshmëri në marrjen e mostrave, dhe një program më rigoroz në monitorimin e kontrollit të cilësive së zbatuar.
  - Permiresim i cilësive së menaxhimit të përqendruar në kontrollin e dokumenteve për të mbajtur procese të qëndrueshme analitike, permiresim i monitorimit të performancës së furnitoreve, si dhe një sistem për trajtimin e komentëve dhe ankesave të klientëve, me permiresim të vazhdueshëm nepermjet procedurave korrigjuese dhe parandaluese të veprimit.
  - Rishikim i menaxhimit të veprimeve korrigjuese , testime jo konforme dhe ndihma në përcaktimin e trendeve testuese afatgjate.
  - Identifikimi i shpejtë në zgjidhjen e çështjeve në lidhje me metodat , personelin ose pajisjet, për rritjen e kenqesive së klientit, plotësimin e kërkesave të cilësive së klientëve të specializuar, si dhe rritjen e përgjithshme të biznesit laboratorik.
7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklarate konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim CE.

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e deklaratës së konformitetit për produktet që kërkohen më sipër, është një kërkesë e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës dhe duke qenë se, Autoriteti Kontraktor është përfitues direkt i kontratës objekt prokurimi është në të drejtën e tij të garantohet se OE-të pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësive së mallit që do të ofertohej, rrjedhimisht është e drejtë e AK-së të kërkojë ofertuesve që të paraqesin deklarate për të vërtetuar konformitetin prodhimit të produkteve të procedurës e prokurimit. Për Autoritetin Kontraktor është e nevojshme që, Operatorët ekonomikë gjatë ofertimit të tyre të provojnë se zotërojnë kapacitetet teknike lidhur me deklaratën e konformitetit për artikujt e kërkuara më sipër. Kërkesa e mësipërme ka si qëllim të sigurojë AK-në, mbi aftësitë teknike të OE fitues në drejtim të përbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standarteve të mirepërcaktuara në DST. Ky kriter nuk është diskriminues dhe është proporcional me objektin e kontratës, si dhe është në zbatim të Nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikate leshuar nga prodhuesi (ose distributori i autorizuar) që kabllo të ofruara janë në përputhje me standardin e harmonizuar Europian HD 626-S1, ose ekuivalentin e saj sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit Shqiptar

**Argumentimi:** HD 626-S1 zbatohet për kabllo të tension nominal  $U_0/U(U_m)=0.6/1(1.2)$  kv të përdorura në sistemet e shpërndarjes së energjisë ajrore kryesisht për shpërndarjen publike, me tension maksimal të shtimit që nuk kalon 1.2 kv. Kjo pjesë (Pjesa 1) specifikon kërkesat e përgjithshme të zbatueshme për këto kabllo, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në seksionet e vecanta të kësaj HD.

9. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale

OSSH sh.a, Elbasan mostrat e mallrave qe perbejne nga nje ze,per cdo artikull, deri momentin e hapjes se ofertave, perkatesisht:

- Gilza me bullon per percjelles ABC 25-70mm<sup>2</sup>
- Kabell ABC me vetembajtje AL 4x95mm<sup>2</sup>
- Kabell AL 4x16mm<sup>2</sup> , izol. XLPE 0.6/1kV
- Kabell koaksial CU-1x6 /6mm<sup>2</sup> (per lidhje te abonenteve 1 fazore)
- Kabell Cu 4x6mm<sup>2</sup> izolacion XLPE 0.6/1kV
- Kabell Cu 4x16mm<sup>2</sup> izolacion PVC 0.6/1kV
- Konektor linje 16-95 mm<sup>2</sup>
- Konektor abonenti 1F 1.5-10/16-95 mm<sup>2</sup>
- Konektor abonenti 3F 35-70/16-95 mm<sup>2</sup>
- Tirantues linje per sistem 4x(70-120) mm<sup>2</sup>

**Argumentimi:** Kriteret e kualifikimit vendosen qe ti sherbejne AK-se sipas referimeve te VKM Nr 285 date 19.05.2021 neni 40 paragrafi 6 i te cilit percakton: *”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastine procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces”.*

**10.** Operatori ekonomik/ofertues duhet te paraqese Tabelat me te dhenat teknike te kablllove te kerkuara , te plotesuara dhe te firmosura nga prodhuesi

**Argumentimi:** Kriteret e kualifikimit vendosen qe ti sherbejne AK-se per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operateve ekonomike te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme si aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur si dhe cdo element tjeter ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne permbushje te kriterit te mesiperm, OE duhet te paraqesin tabelat me te dhenat teknike te kablllove te kerkuara te plotesuara dhe te firmosura nga prodhuesi, per te krijuar bindjen se malli i ofruar eshte Brenda parametrave te kerkuara. Eshte ne te drejten e AK te vertetoje dokumenta teknike qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike te vendosura, perpara se AK te beje perzgjedhjen e OE -se fituese. Kjo kerkese eshte ne perputhje me nenin 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per mioratimin e rregllave te prokurimit publik”

**11.** Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Ames, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar

ose te huaj), per Administratorin / Administratores te shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OSSH sh.a. Elbasan, ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike.**

- *Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi (bazuar ne standartet e OSHEE GROUP sh.a.), duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standartet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.*

## **NJESIA E PROKURIMIT**

**Altin Musollari**

**Klara Beqiri**

**Julmir Boja**

,